



REPUBLICA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA - OPSTINA / MUNICIPALITY  
HANI ELEZIT  
Nr. i Prot. 02 / 117  
Nr. i Faq. 1 Data 04.01.2024



Republika e Kosovës - Republic of Kosova  
Komuna - Municipality

Hani i Elezit

Data:	04.01.2024
PËR :	Departamenti Ligjor i MAPL-së, Besim Murtezani
PËRMES:	Kryetari i Komunës, Mehmet Ballazhi <i>M Ballazhi</i>
NGA :	Shefi i Zyrës Ligjore dhe Përfaqësues Juridik, Bajrush Laçi
LËNDA:	Vendimet e Kuvendit të Komunës Hani i Elezit për muajin Dhjetor, 2023



**I nderuar z. Murtezani;**

**Duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me nr. 03/L-040, përkatësisht, neni 80 nënparagrafi 80.1, dërgojmë vendimet e Kuvendit të Komunës siç vijojnë:**

1. Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit numër 01.nr.9696/2021 me numër 01/10794-2023;
2. Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit numër 01.nr.469/2012, me numër 01.nr.10771/2023;
3. Vendim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik 2024–2028, me numër 01.Nr.10574/2023;
4. Vendim për miratimin e Planit Lokal të Verpimit për barazi gjinore, me numër 01.nr.10287/2023.
5. Vendim për miratimin e Planit të Punës së komiteteve për komunitete për vitin 2024, me numër 01.nr.10276/2023.
6. Vendim për miratimin e Planit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ( KKSB) për vitin 2024, me numër 01.nr.10256/2023.
7. Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kryetarit të komunës për vitin 2024, me numër 01.nr.10286/2023.

Me respekt.



01/ Nr. 10256/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 12 shkronja (d), 40, Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012-MPB-032012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi neni 9 paragrafi 1.7, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2023 merr:

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR**  
**VITIN 2024**

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024 për komunën e Hanit të Elezit.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi,
- Ministria e Punëve të Brendshme,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 28.12.2023

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr.10574/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 40, Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2023 merr:

**VENDIM**

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK 2024-2028 HANIT TË ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për strategjinë për zhvillim ekonomik 2024-2028 të Hani të Elezit.
2. Miratimi i këtij vendimi vjen pas propozimit të ekzekutivit të komunës dhe pas zhvillimit të gjithave procedurave ligjore. Strategjia për zhvillim ekonomik 2024-2028 përmban gjithsej 71 (shtatëdhjetë e një) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:28.12.2023

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 10276/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 55, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2023 merr:

**VENDIM**

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2024

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komiteti për Komunitete,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 28. 12. 2023

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta





01/Nr. 10794/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 51.1, 52, Ligji Nr. 05/L - 031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 53 pika 3, Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë neni 5, Statuti i Komunës neni 37, Rregulloren e Punës së Kuvendit neni 45, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2023 merr:

### V E N D I M

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.9696/2021

1. Kuvendi i komunës miratoi vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.9696/2021 për përbërjen e Komitetit për Politikë e Financa në komunën e Hanit të Elezit.
2. Ndryshohet përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa , z.Refet Kalisi zëvendësohet me znj.Hyriete Isufi, znj.Ibadete Kalisi zëvendësohet me z.Xhevahir Dernjani, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e njëjtë.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data:28.12.2023

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta





01/Nr. 10771/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 53 pika 3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2023 merr:

### VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/NR.469/2012

1. Kuvendi i komunës miratoi propozim vendimin me numër 02/Nr.10771/2023 për rritjen e shumës së shpenzimeve të rasteve mortore në Komunën e Hanit të Elezit, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e njëjtë.
2. Ndryshohet shuma e shpenzimeve të varrimit prej 170.00 €, në 250.00 €.
3. Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Bashkësisë Islame- dega në Han të Elezit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 28. 12. 2023

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta







Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr.10286/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale neni Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Statuti i Komunës neni 24, Rregullorja për Organizimin e Kompetencave dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale 01/Nr.7113/2012 e datës 31.10.2012 neni 4, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2023 merr:

**V E N D I M**  
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS  
PËR VITIN 2024

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.
2. Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2024 përmban aktivitete dhe objektivat e punës së ekzekutivit të komunës në bazë të ligjeve të aplikueshme dhe Statutit të Komunës.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:28.12.2023

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr.10287/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 40, Ligji për Barazi Gjinore Nr.05/L-020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2023 merr:

**VENDIM**

PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2024-2026

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026.
2. Planin lokal i veprimit për barazi gjinore 2024-2026 përmban gjithsej 44 ( katër dhjetë e katër) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data:28.12.2023

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta

